

**Raporti Vjetor 2015**  
**nga Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetese**

I.HYRJE

Në zbatim të organikës së institucionit, e cila do të paraqitet më poshtë, Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit është strukturuar në dy drejtori dhe ne nje sektor: Drejtoria e Studimeve Shkencore, Drejtoria e Arkives dhe Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorit.

Emerimi personelit te institucionit, eshte bere ne zbatim te Ligjit Nr.10242 date 25.02.2010 “Per Institutin e Studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ne Shqiperi” neni 13 i tij si dhe ne baze te VKM-se nr 191, date 23.02.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, organika e institucionit tonë, ka 15 punonjes.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10468, datë 18.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”, numri i punonjësve të institucionit të ISKK për vitin 2015, ka qenë 15 punonjës.

**ORGANIKA E STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË STUDIMEVE PER KRIMET E PASOJAT  
E KOMUNIZMIT NE SHQIPERI**

<i>POZICIONI</i>	<i>NUMRI</i>
I. DREJTORI EKZEKUTIV	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
II. DREJTORIA E ARKIVES/NENDREJTORI	(4)
DREJTOR DREJTORIE/NENDREJTOR	1
SPECIALIST	3
III. DREJTORIA E STUDIMEVE	(5)
DREJTOR DREJTORIE	1
SPECIALIST	4
IV. SEKTORI I BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(4)
PERGJEGJES SEKTORI	1
SPECIALIST	2
SHOFER	1
<u>PUNONJËS GJITHSEJ</u>	<u>15</u>

## II. FAQJA E INTERNETIT

Adresa e internetit te ISKK eshte, [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al), është ndërtuar me krijimin e institucionit, në gjuhën shqip dhe anglisht.

I rëndësishëm për t'u evidentuar është fakti se në adresën e *email*-it [info@iskk.gov.al](mailto:info@iskk.gov.al) të gjithë të interesuarit mund të drejtojnë pyetje dhe të dergojnë informacion që do të ndihmonte edhe me tej punën studimore te institutit.

## III. BUXHETI

Buxheti mbetet i rëndësishëm për realizimin e veprimtarisë së institutit. Në funksion të këtij objekti, buxheti i miratuar për institucionin tonë, në volumin e tij të përgjithshëm, ka qenë si fillim 27 milion lekë. Megjithatë, institucioni ynë ka bërë të mundur që nëpërmjet përdorimit me rigorozitet të buxhetit të miratuar, të realizojë tërësisht detyrimet dhe angazhimet e tij.

Megjithëse totali i shpenzimeve është realizuar në masën 90.62% aspekt ky që tregon se realizimi i shpenzimeve është në nivelin maksimal, megjithatë mosrealizimi është me i ndjeshëm në Shpenzimet Operative . Shpenzimet kapitale të miratuara prej 1.0 milion lekesh janë realizuar në masën 14.5%. U krijuar një fond biblioteke në masën 145 mijë leke pasi pasja e Biblioteke është e rëndësishme për Drejtorinë e Studimeve. Shfrytëzimi në këto masa i këtij fondi plotësoi disa nga kërkesa e tyre për libra për vitin 2015.

Artikulli	Emërtimi	Plani Vjetor (në mijë lekë)	Realizimi vjetor (në mijë lekë)	Realizimi vjetor në %
600	Paga	13,730	13,597	99.03%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	2,370	2,053	86.62%
602	Mallra e shërbime të tjera	10,000	7,909	79.09%
600-606	Shpenzime korente	26,000	23,559	90.62%
231	Shpenzime kapitale	1,000	145	14.5%
Totali i shpenzimeve		27,000	23,704	87.79%

Mbështetur në treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit tone, për periudhën Janar-Dhjetor 2015, situata buxhetore (plani vjetor dhe realizimi faktik, në lekë e përqindje) paraqitet në tabelat e mësipërme:

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

Artikulli	Emërtimi	Realizimi vjetor (në mijë lekë)	Realizimi në raport me totalin e shpenzimeve
600	Paga	13,597	57.36%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	2,052	8.66%
602	Mallra e shërbime të tjera	7,909	33.36%
231	Shpenzime kapitale	145	0.62%
	Totali i shpenzimeve	23,704	100%

Pergjegjes Sektori

Zoica GRACI

Tirane me 15.02.2015